

**KRITERET PËR TË VENDOSUR DEROGIME PËR  
MODULET  
GJENERUESE TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.85, Datë 12.05.2020

2020

## **Baza ligjore për vendosjen e Kritereve për Derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike.**

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) në vendosjen e kritereve për derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike, është bazuar në kompetencat e përcaktuara në Nenet 19(e), 23(1) dhe 63(1) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, në Vendimin nr. 2018/03/PHLG-EnC të Grupit të Përherëshëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë datë 12 Janar 2018, në Kodin e Transmetimit, si dhe në “Kodin e rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin të gjeneruesve”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 129 datë 04.06.2018.

Neni 61 i Rregullores (KE) 2016/631 i transpozuar në legjislacionin kombëtar me anë të Vendimit 129 datë 04. 06. 2018 të Entit Rregullator të Energjisë, përcakton se ERE miraton kriteret për vendosjen e derogimeve në përputhje me dispozitat e Neneve 62 dhe 63 të kësaj rregullore.

Në Nenin 9 të po kësaj Rregulloreje ose ndryshe “Kodi i Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i transpozuar, specifikohet që *“Kostot e lindura nga operatori i sistemit, subjekt i rregullimit të tarifave të rrjetit dhe me prejardhje nga detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore, do të analizohen nga autoriteti rregullator. Kostot të vlerësuara si të arsyeshme, eficiente dhe proporcionale do të mbulohen nëpërmjet tarifës së rrjetit ose mekanizmave të tjerë të përshtatshëm.* Në këto kushte ERE duhet të veçojë kriteret për dhënien e derogimeve nga kërkesat për lidhjen e moduleve gjenerues me një vendim të veçantë.

Neni 60 i “Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” si transpozim i Rregullores KE 2016/631 me anë të Vendimit Nr.129 datë 04. 06. 2018, të miratuar të ERE, me kërkesë të:

1. Pronarit të modulit gjenerues të energjisë elektrike në operim,
2. Pronarit të perspektivës të modulit gjenerues; dhe
3. Operatoreve respektiv të rrjetit, OST sh.a. dhe OSSH sh.a.

ERE mund të japë ose heqë derogimet e dhëna. Kriteret specifike që do të zbatohen për dhënien e derogimeve do të publikohen në faqen zyrtare të ERE, [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al) dhe do të njoftohet Sekretariati i Komunitetit të Energjisë brenda dy muajve mbi to.

### **Perkufizim i termit Derogim**

**Derogim:** është e drejta e nje pale për të mos zbatuar, përmbushur një kërkesë ose standart specifik, apo detyrim që rrjedh nga zbatimi i Vendimit 129, dt.04. 06. 2018 të miratuar nga ERE, për një periudhë të caktuar kohore.

## **I– Kriteret përtë vendosur derogime**

Në rastet kur ERE duhet të marrë vendim lidhur me një kërkesë të paraqitur për derogim nga modulet gjenerues tashmë të lidhur me rrjetin apo që kërkojnë të lidhen me rrjetin, ERE duhet të marrë në konsideratë rrethanat e mëposhtme:

1. Nëse zbatimi në vazhdimësi i disa ose të gjitha dispozitave të Rregullores së transpozuar të Komisionit (KE) 2016/631 mund të ketë ndonjë efekt negativ në sigurinë e operimit dhe qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjitik,
2. Nëse pronarët e moduleve gjenerues të energjisë elektrike në operim ose pronarët e perspektivës të moduleve gjeneruese të energjisë elektrike që kërkojnë të lidhen në sistemin elektroenergjitik janë në gjendje të përmbushin disa ose të gjitha kërkesat e Rregullores, nëse ballafaqohen me probleme të justifikueshme teknike ose ekonomike në lidhje me:
  - a) Llojin e burimit primar të gjenerimit të energjisë elektrike,
  - b) Tipin e gjeneratorit sinkron ose jo-sinkron.

Kriteret që do të aplikohen për derogim do të jenë transparente dhe jo diskriminuese për të gjithë gjeneruesit egzistues apo ata gjenerues që kërkojnë të lidhen në sistemin elektroenergjitik. Një kërkesë për derogim do të refuzohet nëse ka elementë të sjelljes diskriminuese të operatorit përkatës të sistemit në lidhje me rastet identike të lidhjes të moduleve të ngjashme ose identike të gjenerimit. Enti Rregullator mund të rishikojë ose amendojë kriteret për derogim nëse e gjykon si të nevojshëm për shkak të rrethanave që lidhen me kërkesat për zhvillimin e rrjetit. Në rrethana të caktuara ERE mund të anultojë një vendim për një derogim të dhënë.

## **II – Rekomandime shtesë për aplikantët**

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) u rekomandon aplikuesve që kërkojnë derogim të konsultohen me rekomandimet e dokumentit me titull “*Analiza e kostove – përfitimeve-dokument udhëzues për implementimin e kodeve të lidhjes me rrjetin të ENTSO-E*”. Ky dokument është publikuar në faqen e internetit të ENTSO–E, nën seksionin “Kodet e Lidhjes me Rrjetin”. Me poshtë adresa elektronike e faqes së ENTSO\_E.

[https://www.entsoe.eu/network\\_codes/cnc/cnc-igds/](https://www.entsoe.eu/network_codes/cnc/cnc-igds/)

## **III–Kërkesat për derogim duhet të plotësohen duke përdorur formularin sipas shtojcave bashkëlidhur:**

SHTOJCA 1 – Formular i kërkesës për derogim nga Pronarët e objekteve gjeneruese të energjisë elektrike.

SHTOJCA 2 – Formular i kërkesës për derogim nga operatori i sistemit respektiv.

**Formati i kërkesës për derogim nga pronarët e moduleve gjeneruese të energjisë elektrike**

**I– Të dhëna të përgjithshme për aplikantin**

Emri		
Selia		
Adresa		
Adresa e emailit		
Nr.telefon		
Faks		
Aplikanti: Numri i Identifikimit në QKR Licensuar nga ERE me Vendim Nr.....datë Data e lidhjes së Marrëveshjes së Lidhjes.....	<input type="checkbox"/> Zoteruesi i objektit gjenerues	<input type="checkbox"/> Palë e tretë(nëse moduli është i tipit A)
Të dhënat i përkasin:  (shënojeni kur është e përshtatshme)	<input type="checkbox"/> Zoteruesi i objektit gjenerues	<input type="checkbox"/> Palë e tretë (nëse moduli është i tipit A)

**II– Person kontakti i aplikantit**

Emridhe mbiemri		
Pozicioni		
Adresaemailit		
Numratetelefonit		
Të dhënat i përkasin: (shënojeni kur është e përshtatshme)	<input type="checkbox"/> Zoteruesi i objektit gjenerues	<input type="checkbox"/> Palë e tretë

**III–Tëdhënatbazëpërobjektin**

Emri		
Tipi i modulit gjenerues(A, B, C, D, sinkron, josinkron)		
Lloji i burimit primar të energjisë		
Vendndodhja/pika e lidhjes		
Kapaciteti instaluar[kW]ose(MW)		
Tensionii lidhjes[kV]		
Çertifikata e pajisjes lëshuar nga nje certifikues i autorizuar (shënojeni sipas nevojës)	Po	Jo
Jetëgjatësia		
Koha e pritshme e vendosjes në punë		

Referenca në dispozitat për të cilat kërkohet kufizimi dhe shkaqet e detajuara	
Per sa kohe kërkohet derogimi (jave, muaj, vit)	Nga _____ deri _____

#### IV– Lista e dokumentave

##### a) Dokumentat bazë

<b>Prova</b>	<i>Të paraqitura (shënonimë poshtë kur është nevojshme)</i>	
Përshkrimi i moduleve gjeneruese për të cilat kërkohet derogim	Po	Jo
Përshkrim i detajuar për derogimin që kërkohet	Po	Jo
Arsyetim i detajuar i shkaqeve së bashku me dokumentat mbështetës dhe analizën kosto-përfitim	Po	Jo
Demonstrim që derogimi i kërkuar nuk ka efekte të kundërta tek tregëtia ndër– kufitare	Po	Jo

##### b) Dokumenta të tjera

Nr.	Emri i Dokumentit
1.	Analiza e kostos ne bashkëpunim e operatorin e sistemit ku eshte lidhur gjeneruesi
2.	
3.	
4.	
5.	

Vendi dhe data ku është plotësuar kërkesa	Vendi: _____ Data: _____
Emri dhe Mbiemri i Personit përgjegjës	
Firma e personit përgjegjës dhe vula	

**Formati i kërkesës përkufizime nga operatori përkatës i sistemit.****I– Të dhëna të përgjithshme për operatorin e sistemit**

Emri	
Selia	
Adresa	
Adresa e emailit	
Nr.telefon	
Faks	

**II– Personi i kontaktit i operatorit të sistemit**

Emridhe mbiemri	
Pozicioni	
Adresa e email	
Numrat e telefonit	

**III– Të dhëna bazë për objektin**

Emri	
Tipi i modulit gjenerues (A, B, C, ose D,)	
Lloji i burimit primar të energjisë	
Vendndodhja	
Numri i moduleve gjenerues	
Kapaciteti totali instaluar [kW]	
Tensioni i lidhjes[kV]	
Çertifikata e prodhuesit të pajisjes lëshuar nga një certifikues i autorizuar	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
Jetëgjatësia	
Koha e pritshme vendosjes në punë	
Referenca ne dispozitat për të cilat kërkohet derogimi	
Koha e pritshme e deklaruar nga aplikuesi për heqjen e derogimit	Nga _____ Deri _____

#### IV– Lista e dokumentave

##### a) Dokumentat bazë

Prova	Të paraqitura (shënoni Po ose Jo)	
Përshkrimi moduleve që gjenerojnë fuqi për të cilat kërkohet kufizim dhe kapaciteti total i instaluar si dhe numri i moduleve që gjenerojnë fuqi	Po	Jo
Përshkrim i detajuar i derogimit që kërkohet	Po	Jo
Arsyetim i detajuar i shkaqeve së bashku me dokumentat bashkëlidhur si dhe analiza kosto – përfitim.	Po	Jo
Demonstrim që kufizimi i kërkuar nuk ka efekte të kundërta tek tregëtimi ndër-kufitar i energjise elektrike.	Po	Jo

Analiza kosto – përfitim (nëse aplikohet, analiza kosto përfitim kryhet nga operatori i rrjetit respektiv ku është lidhur gjeneruesi OST sh.a., ose OSSH sh.a.) PO ose JO.

**b) Dokumenta të tjera**

Nr.	Emri i Dokumentit
1.	
2.	
3.	
4.	
5.	

Vendi dhe ora kur është Plotësuar kërkesa	Vendi:                      Data:
Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës	
Firma e personit përgjegjës dhe vula	